

2.5 LEJET PËR KATALOGIMIN E PËRBASHKËT

Në sistemin e katalogimit të përbashkët mund të bashkëpunojnë bibliotekarët, të cilët kanë kualifikimin përkatës dhe zotërojnë rregullat e katalogimit, standardet e tjera bibliografike dhe formatet COMARC.

Dhënia e lejeve për katalogimin e përbashkët përkon edhe me ndryshimin e konceptit të katalogimit të përbashkët në mjedisin COBISS3. Krahas lejeve për katalogimin e monografive, serialeve dhe artikujve, jepen edhe lejet për katalogimin e burimeve në vazhdim, materialeve jolibra dhe antikuareve.

Kategoritë e lejeve/autorizimeve për krijimin e regjistrimeve bibliografike janë:

- leja A – marrja e autorizimeve për katalogimin e përbashkët të monografive si dhe krijimin e regjistrimeve përmbledhëse dhe regjistrimeve për veprat e ekzekutuara (ngjarjet)
- leja B1 – marrja e autorizimeve për katalogimin e përbashkët të pjesëve përbërëse
- leja B2 – marrja e autorizimeve për katalogimin e përbashkët të burimeve në vazhdim
- leja C – marrja e autorizimeve për katalogimin e përbashkët të materialeve jo libra
- leja D – marrja e autorizimeve për katalogimin e përbashkët të antikuareve

Të gjitha këto leje përfshijnë edhe autorizimet për shkarkimin e regjistrimeve nga formati MARC 21 (Katalogu online i Bibliotekës së Kongresit, WorldCat) dhe autorizimet për redaktimin e regjistrimeve në COBIB.

Kataloguesit, të cilët regjistrimet vetëm i shkarkojnë nga baza e përbashkët e të dhënave COBIB, nuk kanë nevojë për autorizimet e përmendura më lartë.

Është plotësuar edhe procedura për marrjen e lejeve të veçanta.

Në Slloveni procedura e marrjes së lejeve për katalogimin e përbashkët është e rregulluar me dokumentin *Pridobitev dovoljenja za vzajemno katalogizacijo v sistemu COBISS.SI (Marrja e lejeve për katalogimin e përbashkët në sistemin COBISS.SI)*. Dokumentin e ka pranuar Biblioteka Kombëtare dhe Universitare (NUK) dhe Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM), të cilët bazuar në nenin 44 dhe 47 të Ligjit për bibliotekat (ZKnj-1, Gazeta zyrtare e RS-së, nr. 87/01, 96/02 – ZUJIK dhe 92/15), janë të autorizuar për kualifikimin e punonjësve të bibliotekave për bashkëpunim në katalogimin e përbashkët.

Orari i kualifikimit dhe aftësimin për marrjen e lejeve të veçanta është i publikuar në programin e kualifikimit të NUK-ut dhe IZUM-it. Të gjitha aktivitetet mund t'i përcillni në portalin *Kualifikimi* të IZUM-it, së bashku me dokumentet e tjera të rëndësishme.

Për dhënien e lejeve për katalogimin e përbashkët në shtetet e tjera janë të autorizuar bibliotekat kombëtare, të cilat duhet të përgatisin procedurat përkatëse formale dhe transparente.